



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1360 Prot.

Tiranë, më 01.09 2025

URDHËR

Nr. 107, Datë 01/09 /2025

PËR


MARRJEN E MASAVE PËR ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR, CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE TË DATËS SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR PËRGJEGJËS TË NJËSIVE BAZË KMDP, KANTO DHE SKULPTURË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Mbështetur në nenin 36, pika 7, në nenin 39 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin nr. 101, datë 13.03.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, në nenin 22, pika 6 dhe në nenin 27, pika 2 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 12 dhe nenin 5, pika 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve”, të miratuar me Vendimin nr. 17 datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të UART si dhe bazuar në faktin që drejtuesit e njësive bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë janë të komanduar në këtë detyrë, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të mbajtura në rang institucional më 21 Qershor 2024 si dhe pas thirrjes së pasuksesshme të bazuar në Urdhrin e Rektorit nr. 49, datë 29.10.2024,

URDHËROJ:

1. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për Përgjegjës të Njësive Bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve është 15 Shtator 2025.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për Përgjegjës të Njësive Bazë KMDP, Kanto dhe Skulpturë në Universitetin e Arteve është 15 Tetor 2025.
3. Përfundimin e fushatës zgjedhore 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore, gjatë së cilës nuk lejohet asnjë lloj fushate.
4. Angazhimin e Administratorit dhe administratës së UART për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe të barabarta të gjithë kandidatëve për të zhvilluar aktivitetet e tyre në kuadër të fushatës elektorale.
5. Ky urdhër t’i përcillet Administratorit, Dekanëve në fakultete si dhe KIZ-it dhe KZF-ve.
6. Ky urdhër të publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


REKTORI
Prof. Dr. Erald Bakalli